



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 33/1 Prot.

Tiranë, më 10/8/2011

Lënda: Rekomandim për **“Grand Hotel Europa” Shkodër .**

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **“Grand Hotel Europa” Shkodër ,**

KONSTATOVA

Më datë 06.07.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, **“Grand Hotel Europa” Shkodër ,** me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë punonjës etj).
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemit të kamerave(CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi “Grand Hotel Europa” Shkodër gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë, klientë, punonjës dhe furnizues.

Ky kontrollues gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij përhap të dhënat personale të klientëve drejt subjekteve të tilla si Drejtoria e Tatim-Taksave, Ministria e Turizmit etj në kuadër të detyrimeve ligjore që ka ndaj këtyre subjekteve.

Gjatë kontrollit u konstatua se, kontrolluesi nuk kryen transferim ndërkombëtar të të dhënave personale për kategorinë “klientë”.

Lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale për kategoritë klientë, punonjës dhe furnizues rezulton që pranë kontrolluesit “Grand Hotel Europa” Shkodër nuk konstatohen shkelje ligjore të përcaktuara në **nenit 5** të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” lidhur me përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme, grumbullimin për qëllime specifike të përcaktuara qartë e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime, në mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilat ato janë grumbulluar dhe përpunuar.

Nuk u konstatuan shkelje të kontrolluesit lidhur me mjaftueshmërinë, qëllimin e përpunimit, tejkalimin e qëllimit, saktësisë dhe përditësimin e të dhënave personale.

Kontrolluesi “Grand Hotel Europa” Shkodër, dokumentacionet që mbartin të dhëna personale i ruan në zyrën e financës në të cilën ka krijuar një arkivë fizike. Arkiva është e sigurt e pajisur me rafte për vendosjen e dosjeve. Dosjet mbahen të ndara sipas kategorive për klientët, punonjësit dhe furnizuesit. Zyra e financës së kontrolluesit është e sigurt dhe akses në këtë zyrë ka vetëm punonjësi që është i ngarkuar me detyrën e shefit të financës. Të dhënat që kontrolluesi përpunon në rrugë elektronike ruhen në një aplikacion të ndërtuar në “Microsoft Access”. Në këtë aplikacion ruhen të dhëna si emri, mbiemri, nr. i pasaportës si dhe datat e prenotimit për çdo klient. Çdo punonjës është i pajisur me emër përdoruesi si dhe fjalëkalim për të pasur akses në këtë aplikacion. Kompjuteri është i pajisur me antivirus.

Kontrolluesi “Grand Hotel Europa” Shkodër, në aktivitetin e tij hoteleri turizëm, grumbullon të dhëna personale video nëpërmjet sistemit të video vëzhgim-regjistrimit (CCTV).

Qëllimi i përdorimit të sistemit video vëzhgim-regjistrimi nga ana e kontrolluesit është vëzhgimi i ambienteve si dhe marrja e masave për forcimin dhe rritjen e sigurisë së vazhdueshme në ambientet e kontrolluesit “Grand Hotel Europa”;

Salla operative, ku është vendosur sistemi i video vëzhgim-regjistrimit ka akses të kufizuar. Akses në këtë ambient kanë vetëm 2 punonjësit e sigurisë si dhe shefi i sigurisë së këtij kontrollu Ekziston një rregullore teknike në të cilën është përcaktuar qëllimi i vëzhgimit dhe grumbullimit të të dhënave me anë të sistemit (CCTV), përcaktimi i hierarkisë, përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi përkatese për punonjësit e sigurisë si dhe marrja e masave në rast shkelje të kësaj rregulloreje.; Sistemi i video vëzhgim-regjistrimit (CCTV), monitoron

korridoret, parkingun, hyrjen në hotel, ambientet e brendshme si dhe të jashtme të kontrolluesit “Grand Hotel Europa”; Sistemi grumbullon të dhëna video nga kamerat e instaluar në të gjitha ambientet e sipërpërmendura të kontrolluesit; Sistemi regjistron të dhënat video për një periudhë 5-6 ditore (maksimumi i kapacitetit të DVR-video regjistruar dixhital); Akses në të dhënat video të regjistruara nga sistemi i video vëzhgim-regjistrimit (CCTV) kanë vetëm punonjësit e autorizuar nga drejtuesi i kontrolluesit “Grand Hotel Europa”; U konstatua tabelë informuese në lidhje me mbikëqyrjen e ambienteve me anë të sistemit të vëzhgim-regjistrimit (CCTV) në hyrje të hotelit, por kjo tabelë informuese duhet të vendoset në të gjitha ambjentet që mbikëqyren me kamera.

- Në këtë rast duhet të zbatohet neni 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe Udhëzimi nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”.

Kontrolluesi “Grand Hotel Europa” Shkodër nuk ka plotësuar detyrimin për njoftim pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 pikal e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... ..“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë”.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

- Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Grand Hotel Europa” Shkodër , duhet të përmbushë detyrimin lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, të vendosen tabela informuese në të gjitha ambjentet të cilat mbikëqyren me kamera (sipas modelit standart të miratuar nga Komisioneri me Urdhërin Nr. 33, datë 27.06.2011. Tabela standard

informuese mund ta shkarkoni në format “.pdf” nga faqja zyrtare e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, www.kmdp.al).

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

